



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

PROJEKT-VENDIM

Nr.____, datë ____ . ____ . 2025

PËR MIRATIMIN E DHËNIES SHOQERISË ERSEKA SOLAR PARK 3 LOT 1 SH.P.K TË SË DREJTËS SE KALIMIT TE KORRIDORIT TE LINJES ELEKTRIKE ME VENDNDODHJE NË BASHKINË KOLONJË, QARKU KORÇË, NË PRONAT SHETËTËRORE NË PRONËSI TË BASHKISË KOLONJË.

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 datë, 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", ndryshuar, Ligjit nr.107/2016 "*Për Prefektin e Qarkut*", Ligjit nr.115/2014 "*Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë*", Ligjit nr.8744 datë 22.02.2001 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore*" Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 247 datë, 27.03.2013 "*Për miatimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Qendër Ersekë të Qarkut të Korçës*", aktualisht me ndarjen e re Administrativo-territoriale me Ligjin nr. 115/2014 "*Për ndarjen Administrativo-Territoriale te Njesive te Qeverisjes Vendore ne Republiken e Shqiperisë*" të ndryshuar, kanë kaluar në pronësi/përdorim të Bashkisë Kolonjë, kërkesës Nr. 15 Prot., Datë 18.08.2025 të shoqërisë Erseka Solar Park 3 Lot 1 sh.p.k, person juridik shqiptar me NIPT M54007002H, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës, 15.09.2025,

PROPOZOI:

1.Të miratojë dhënien Shoqërisë Erseka Solar Park 3 Lot 1 sh.p.k për efekt të kalimit të korridorit të Linjës Elektrike për projektin impianti Fotovoltaik "*Erseka Solar Park 3, Lot 1*" me vendndodhje në Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë të së drejtës së kalimit për korridor linje elektrike në pasuritë shtetërore të mëposhtëme në pronësi të Bashkisë Kolonjë:

- Pasuria nr.132/33, ZK. 3510, Starje, Kolonjë, 0.009 km (shkëmbore)
- Pasuria nr.360, ZK. 3510, Starje, Kolonjë, 0.097 km (Ledh)
- Pasuria nr. 93/58, ZK. 3510, Starje , Kolonjë, 0.011 km (Ledh)

2.Lidhjen dhe nënshkrimin për këtë qëllim të Kontratës/Marrëveshjes përkatëse konform kuadrit ligjor në fuqi me shoqërinë Erseka Solar Park 3 Lot 1 sh.p.k..

3.Ky p/vendim hyn në fuqi në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 datë, 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*", i ndryshuar.

KRYETARI
Erion Isai

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

NËNKRYETAR

Petro Risto

Adresa: Sheshi "Rilindja" Ersekë, Kolonjë, www.kolonja.gov.al, email: info@kolonja.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr. 4834 Prot

Ersekë, më 10.09.2025

RELACION
PËR
PROJEKT VENDIM

Nr. ____, datë __. __. 2025

**PËR MIRATIMIN E DHËNIES SHOQERISË ERSEKA SOLAR PARK 3 LOT 1 SH.P.K TË SË
DREJTËS SE KALIMIT TE KORRIDORIT TE LINJES ELEKTRIKE ME VENDNDODHJE
NË BASHKINË KOLONJË, QARKU KORÇË, NË PRONAT SHETETËRORE NË PRONËSI TË
BASHKISË KOLONJË.**

Të nderuar këshilltarë,

- **Pasuria nr. 132/33 ZK 3510:** e llojit “shkëmbore” është e pashfrytëzueshme për bujqësi. Kjo kategori toke klasifikohet si “tokë e pafrytshme”, në përkufizim të Ligjit nr. 8752 datë, 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar, si “**Tokë e pafrytshme**” kuptohet toka cilësisht e dobët, që nuk përfshihet në zërat kadastralë: tokë bujqësore, tokë pyjore, pyje, kullota, livadhe e troje”.

- **Pasuria nr. 360 ZK 3510** e llojit “Ledh” ndodhet në listën e miratuar me Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 247 datë, 27.03.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Qendër Ersekë të Qarkut të Korçës” tokat jo bujqësore janë transferuar në pronësi të Komunës Qendër Ersekë.

- **Pasuria nr. 93/58 ZK 3164** e llojit “Ledh” ndodhet në listën e miratuar me Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 247 datë, 27.03.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Qendër Ersekë të Qarkut të Korçës” tokat jo bujqësore janë transferuar në pronësi të Komunës Qendër Ersekë.

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 247 datë, 27.03.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Qendër Ersekë të Qarkut të Korçës”, prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (Toka jo produktive) me nr. 333 rendor tokë jo bujqësore.

Konceptoi: Specialist **O. Maili**

Miratoi: Drejtori D.B.ZH.R **G. Eminaj**

Konfirmoi: Drejtori D.C.J.P.P


O.Lifo

KRYETARI
Erion Isai

NË MUNGESË DHE MË URDHËR

NËNKRYETAR
Petro Risto

Adresa: Sheshi “Rilindja” Ersekë, Kolonjë, www.kolonja.gov.al, email: info@kolonja.gov.al



Plani vendosjes se
linjes elektrike ajrore
Starje - Rehove
Fragmenti ne pasuria
nr. 93/58 ZK 3164

93/55

93/58

93/56

93/50

3510³⁶⁴

S

Plani vendësjes se
linjes elektrike ajrore
Starje - Rehove
Fragmenti ne pasuria
nr. 360 ZK 3510

361/3

Gjatesia 87 ml

360

Gjatesia 10 ml

0m - 10m

Plani vendisjes se
linjes elektrike ajrore
Starje - Rehove
Fragmenti ne pasuria
nr. 132./33 ZK 3510

